



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**INSTITUTI I KONTABILISTËVE TË MIRATUAR**

**RREGULLORE**

**Nr. 5, datë 08.05.2018**

**PËR KONTROLLIN E CILËSISË DHE DHËNIEN E SIGURISË  
PER SHERBIMET E KRYERA NGA KONTABILISTET E MIRATUAR**

Bazuar në kërkesat e Nenit 24/1 dhe Nenit 24/2 të statutit të IKM, të ligjit 10091 date 05.03.2009 “PËR AUDITIMIN LIGJOR, ORGANIZIMIN E PROFESIONIT TË AUDITUESIT LIGJOR DHE TË KONTABILISTIT TË MIRATUAR” i ndryshuar dhe te Rregullores Nr. 9 të BMP, hartohet rregullorja e mëposhtëme.

**TE PERGJITHSHME**

Kontabilist i Miratuar, është një profesionist i pavarur, i cili e ushtron veprimtarinë profesionale në përputhje me kërkesat e Ligjit 10091 date 05.03.2009 “PËR AUDITIMIN LIGJOR, ORGANIZIMIN E PROFESIONIT TË AUDITUESIT LIGJOR DHE TË KONTABILISTIT TË MIRATUAR” i ndryshuar me Ligjin 47/2016 date 28.04.2016.

Anetare të IKM janë:

- A. Profesionisti i punësuar ose i vetepunësuar, i cili zoteron dëshminë si “Kontabilist i Miratuar” ose vertetimet e provimeve të “Kontabilistit të Miratuar”
- B. Shoqëria e Kontabilitetit e cila është e organizuar si shoqëri tregtare, në përputhje me ligjin përkatës dhe administrohet nga një ose më shumë persona të cilët janë pajisur me dëshminë e “Kontabilistit të Miratuar” dhe të cilët zoterojnë jo më pak se 50 përqind e të drejtave të votës në kapitalin e shoqërisë

Te cilët kanë pranuar vullnetarisht kërkesat e statutit të IKM.

Komiteti i Kontrollit të Cilësisë është një organizëm i krijuar në përmbushje të detyrimeve statutore për mbikqyrjen dhe monitorimin e Cilësisë së angazhimeve të anetareve të IKM. Komiteti i Kontrollit të Cilësisë monitoron përmes zbatimit të rregullave dhe standardeve profesionale dhe të Kodit të Etikës, kryerjen e angazhimeve profesionale të tyre.



Asambleja e Përgjithshme ka miratuar keto rregulla që do të drejtojnë Kontrollin e Cilesise dhe dhenien e sigurise për shërbimet e kryera nga Kontabilistet e Miratuar.

**Neni 1**  
**Qellimi**

Ne përputhje me Nenin 38 dhe Nenit 39 të Ligjit 10091 datë 05.03.2009 “PËR AUDITIMIN LIGJOR, ORGANIZIMIN E PROFESIONIT TË AUDITUESIT LIGJOR DHE TË KONTABILISTIT TË MIRATUAR” i ndryshuar, për të garantuar cilesinë e angazhimeve profesionale të anëtarëve të IKM, ngrihet dhe funksionon sistemi i Dhenies së sigurise për cilesinë i cili përfshin:

- a) Kontrollin e Cilesise në nivel angazhimi individual të Kontabilistit të Miratuar
- b) Kontrollin e Cilesise për shërbimet e ofruara nga Shoqëritë e Kontabilitetit

Kontrolli i Cilesise në nivel angazhimi individual për Kontabilistet e Miratuar, garantohet, duke u mbështetur në Standardin Nderkombëtar për Kontrollin e Cilesise (ISQC 1) si dhe nga zbatimi i Kodit të Etikës.

Kontrolli i Cilesise për shërbimet e ofruara nga Shoqëritë e Kontabilitetit, garantohet përmes vendosjes së rregulloreve të brendshme të rishikimit për qëllime të Kontrollit të Cilesise të angazhimeve, në përputhje me Standardin Nderkombëtar për Kontrollin e Cilesise (ISQC 1) për sa mund të aplikohet në Shoqëritë e Kontabilitetit, si dhe “Udhëzuesin mbi menaxhimin e bizneseve të vogla dhe të mesme në Profesionin Kontabel”.

Kontrolli i Cilesise që organizohet nga IKM, është procedura e shqyrtimit nga Këshilli Drejtues në lidhje me veprimtarinë profesionale të një Kontabilisti të Miratuar dhe Shoqërive të Kontabilitetit vendase dhe të huaja anëtare të IKM, nëpërmjet Komitetit të Kontrollit të Cilesise. Këshilli Drejtues nëpërmjet Komitetit të Kontrollit të Cilesise, ndërton procedurat dhe realizon Kontrollin e Cilesise bazuar në:

- a) Statutin e IKM
- b) Rregulloren e Kontrollit të Cilesise
- c) Standardin Nderkombëtar për Kontrollin e Cilesise (ISQC 1)
- d) Kodin e Etikës

Kontrolli i Cilesise, ka për qëllim të verifikojë dhe të japë siguri të mjaftueshme se Kontabilisti i Miratuar dhe Shoqëritë e Kontabilitetit anëtare të IKM, gjatë ushtrimit të profesionit të tyre dhe gjatë kryerjes së shërbimeve profesionale respektojnë kërkesat ligjore, rregullat e brendshme të



## **Instituti i Kontabilistëve të Miratuar të Shqiperisë** **Albanian Institute of Certified Accountants**

---

IKM, Standardet Nderkombetare per Kontrollin e Cilesise dhe se organizimi i Shoqerive te Kontabilitetit i pergjigjet nevojave te ushtrimit te profesionit.

Ne mbeshtetje te misionit te IKM, procedurat e Kontrollit te Cilesise kane per qellim te arrijne perpmiresime te rendesishme ne cilesine e pergjithshme te sherbimeve te ofruara nga Kontabilistet e Miratuar dhe Shoqerite e Kontabilitetit, anetare te IKM.

K Kontrolli i Cilesise organizohet ne menyre te tille qe te jete i pavarur nga Kontabilistet e Miratuar dhe Shoqerite e Kontabilitetit, te cilat po kontrollohen.

### **Neni 2** **Detyrimi per Kontroll**

K Kontrolli i Cilesise eshte i detyrueshem per te gjithë anetaret e IKM (te vetepunesuar, te punesuar, dhe Shoqerite e Kontabilitetit).

Anetaret qe refuzojne t'i nenshtrohen ketij kontrolli, bejne nje shkelje te rregullave te parashikuara ne Kodin e Etikes te IKM dhe i nenshtrohen procedurave disiplinore te parashikuara ne Rregulloren e Investigimit dhe Disiplines.

K Kontrolli i Cilesise, kryhet prane vendndodhjeve te subjektit qe do te kontrollohet ose ne raste te caktuara prane zyrrave te IKM. Kontrolli per cilesine shtrihet mbi teresine e organizimit dhe te veprimtarise profesionale te Kontabilistit te Miratuar, dhe te Shoqerise se Kontabilitetit.

### **Neni 3** **K Kontrolli i Cilesise**

K Kontrolli i Cilesise realizohet permes kontrollit te sherbimeve te kontabilitetit, rishikimit ne dhenien e sherbimeve te tjera, organizimit dhe rregulloreve te brendshme; te perzgjedhura nga ana e Komitetit te Kontrollit te Cilesise dhe perfshin nje vleresim te pajtueshmerise me Standardet e zbatueshme te kontabilitetit, kerkesat e Kodit te Etikes dhe te pavarise, pajtueshmerise me Standardet Nderkombetare te Kontrollit te Cilesise, si dhe nje vleresim te cilesise dhe sasise se burimeve te shpenzuara, te tarifave te perdorura.

Ne perfundim te kontrollit, pergatitet nje raport nga Eksperti Kontrollues, i cili permban gjetjet faktike dhe konkluzionet kryesore te arritura gjate kryerjes se kontrollit. Ky raport i paraqitet Komitetit te Kontrollit te Cilesise.



## Instituti i Kontabilistëve të Miratuar të Shqiperisë Albanian Institute of Certified Accountants

---

Ne rast mosmarreveshje ndërmjet Ekspertit Kontrollues dhe subjektit të kontrolluar, arbitrimi bëhet nga Komiteti i Kontrollit të Cilesise, pasi subjekti i kontrolluar ka paraqitur formalisht me shkrim, qendrimin e tij.

Kontrollet realizuara nga Ekspertet Kontrollues duhet të përmbledhen në Raportin Vjetor të punës. Raportet duhet të aprovohen nga Keshilli i Drejtimit dhe me pas të raportohen në Asamblenë e Përgjithshme në mbledhjen e radhës. Komiteti i Kontrollit të Cilesise duhet të përgatisë përmbledhjen e Raportit Vjetor duke evidentuar pikat e forta dhe mangësitë në cilësinë e shërbimeve të kontabilitetit, duke nxjerrë në pah përmirësimet e bëra nga rishikimi i fundit, si dhe duke përfshirë konkluzionet, rekomandimet dhe Planin e Veprimit për periudhën në vijim.

Kontrolli i Cilesise kryhet për çdo anëtar (i punësuar, i vetëpunësuar ose shoqëri kontabiliteti):

- a) Brenda 3(tre) viteve pas certifikimit për anëtarët e rinj
- b) Një herë në çdo 5(pesë) vite për çdo anëtar, dhe pas kontrollit të parë
- c) Çdo 3(tre) vite për ata Kontabilistë të Miratuar (Persona Fizike ose Shoqëri Kontabiliteti) që përgatisin pasqyra financiare për Njësitë Ekonomike me Interes Publik (NIP)

Bazuar në shkaqë të arsyeshme, IKM mund të realizojë Kontrollin e Cilesise me shpesh.

### **Neni 4**

#### **Organizimi i Komitetit të Kontrollit të Cilesise**

Komiteti i Kontrollit të Cilesise përbehet nga 3(tre) anëtarë Kontabilistë të Miratuar, dy prej të cilëve janë anëtarë të shoqatës, ushtrues të profesionit dhe një të jetë nga fusha akademike ose profesionist i kontabilitetit apo auditimit që nuk e ushtron profesionin. Komiteti i Kontrollit të Cilesise zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë 2(dy) vjetecare por jo më shumë se dy mandate.

Kryetari i Komitetit të Kontrollit të Cilesise, caktohet anëtari që ka fituar numrin më të madh të votave dhe në rast votash të barabarta, anëtarin më të moshuar. Pozicioni i Presidentit dhe zv/Presidentit të Keshillit Drejtues të IKM është i papajtueshëm me funksionin e Komitetit të Kontrollit të Cilesise.

Në rast revokimi, dorëheqje ose çdo rasti tjetër të pengimit të anëtarëve të Komitetit të Kontrollit të Cilesise, Asambleja e Përgjithshme mund të kooptoje, deri në kryerjen e zgjedhjeve të ardhshme, një anëtar tjetër, që në zgjedhjet e mëparshme ka fituar numrin më të madh të votave, por nuk ka qenë zgjedhur si Anëtar i Komitetit të Kontrollit të Cilesise.



## Instituti i Kontabilistëve të Miratuar të Shqiperisë Albanian Institute of Certified Accountants

Bazuar ne sa me siper, Keshilli i Drejtimit, brenda nje muaji nga data e largimit te nje anetari te Komitetit te Kontrollit te Cilesise, vendos caktimin provizor te kandidatit deri ne mbledhjen e radhes se Asamblese se Pergjithshme.

Numri i anetareve te kooptuar nuk mund te jete me shume se nje. Neqoftese krijohet me shume se nje vend vakant, atehere Asambleja e Pergjithshme duhet te mblidhet, per te zgjedhur aq anetare sa mungojne, perfshire dhe anetaret e kooptuar.

Anetaret e rinj te zgjedhur perfundojne mandatin e anetareve qe kane zevendesuar.

Komiteti i Kontrollit te Cilesise vepron ne baze te "Rregullores per Kontrollin e Cilesise dhe Dhenien e Sigurise per Sherbimet e kryera nga Kontabilistet e Miratuar", kjo e fundit e miratuar nga Asambleja e Pergjithshme e IKM.

### Neni 5

#### Detyrat e Komitetit te Kontrollit te Cilesise

Komiteti i Kontrollit te Cilesise ka te drejtat dhe detyrat e meposhtme:

- a) Te implementoje dhe te ruaje sistemet e pershtatshme per Kontrollin e Cilesise
- b) Te hartoje procedurat qe do te zbatohen per te perzgjedhur anetaret qe do t'i nenshtrohen Kontrollit te Cilesise
- c) Paraqet listen e anetareve qe do t'i nenshtrohen Kontrollit te Cilesise prane Keshillit te Drejtimit te IKM per miratim
- d) Te hartoje udhezues pune (manual) per kontrollin, bazuar ne udhezimet e publikuara nga Federata Nderkombetare e Kontabilistëve (IFAC), i cili miratohet nga Keshilli i Drejtimit
- e) Te hartoje Programin Vjetor te Kontrollit te Cilesise, i cili miratohet nga Keshilli i Drejtimit te IKM. Programi duhet te paraqitet prane Keshillit te Drejtimit brenda tremujorit te pare te vitit pasardhes ne zbatim te kerkesave te Statutit
- f) Te pergatise permbledhjen e Raportit Vjetor te punes, i cili miratohet nga Keshilli i Drejtimit dhe me pas raportohet ne mbledhjen e radhes se Asamblese se Pergjithshme
- g) Te hartoje dhe propozoje procedurat e perzgjedhjes se Eksperteve Kontrollues, te cilat miratohen nga Keshilli i Drejtimit te IKM
- h) Te pergatise dhe azhurnoje tematiken e Kontrollit te Cilesise
- i) Te percaktoje periodicitetin e kontrollit si dhe kohen e nevojshme per cdo kontroll
- j) Te percaktoje koston e kontroleve dhe menyren e perballimit te koston
- k) Te marre materialet dhe konkluzionet e grupeve te eksperteve kontrollues dhe bazuar ne rezultatet e kontrollit te organizoje seancen degjimore per ata anetare te kontrolluar te cilet ankimojne rezultatet e kontrollit



- l) Te pergatise vleresimet paraprake per perfundimet e rezultateve te kontrollit dhe t'ia komunikojë ato Keshillit te Drejtimit
- m) Te hartojë Modelin e Raportit ne lidhje me Kontrollin e Cilesise te kryer, se bashku me anekset perkatese, te cilat i paraqiten per miratim Keshillit te Drejtimit
- n) Te hartojë modelin e Deklarates se Konfidencialitetit ne lidhje me Kontrollin e Cilesise
- o) Te beje propozime dhe rekomandime per masat qe duhen marre ndaj Kontabilistit te Miratuar, dhe nese eshte e nevojshme t'i paraqese keto prane Komitetit te Investigimit dhe Disiplines
- p) Te hartojë module trajnimi dhe informimi per anetaret e shoqates lidhur me rendesine e te kuptuarit dhe te aplikuarit te Kontrollit te Cilesise ne nivel anetari te IKM
- q) Për realizimin e detyrave të tij Komiteti i Kontrollit te Cilesise mbështetet nga stafi ekzekutiv përkatës i caktuar nga Drejtori ekzekutiv i IKM

#### **Neni 6**

#### **Ekspertet Kontrollues**

Kontrolli i Cilesise kryhet nga Ekspertet Kontrollues, te cilet jane Kontabiliste te Miratuar anetare te IKM-se. Perzgjedhja e Eksperteve Kontrollues per Kontrollin e Cilesise behet nga Komiteti i Kontrollit te Cilesise, ne baze te nje procedure objektive, e cila jep garanci se nuk ka Konflikt Interesi ndermjet Ekspertit Kontrollues dhe subjektit te kontrolluar.

Procedura e perzgjedhjes se Eksperteve Kontrollues eshte e percaktuar me vendim te Keshillit te Drejtimit. Keshilli i Drejtimit vendos per kriteret e perzgjedhjes se fondit te anetareve te cilet mund te veprojne si Ekspert Kontrollues, te cilat i paraqiten se bashku me Rregulloren per miratim, Asamblese se Pergjithshme. Kriteret mund te ndryshohen perseri nepermjet ndryshimeve te miratuara nga Keshilli i Drejtimit.

Ne fazen e dyte behet perzgjedhja rastesore brenda ketij Fondi.

Qe nje anetar i IKM te behet anetar i Fondit te Eksperteve Kontrollues duhet te plotesoje kriteret e meposhteme:

- a) Te kete 5(pese) vite pervoje ne ushtrimin e profesionit
- b) Te kete marre pjese rregullisht ne Edukimin e Vijueshem gjate 3(tre) viteve te fundit
- c) Gjate periudhes qe ka qene anetar i IKM, mos te kete marre asnje mase disiplinore nga Komiteti i Investigimit dhe Disiplines se IKM, ose mase administrative nga autoritetet perkatese
- d) Te dallohet per nivelin e tij profesional, integritetin dhe pavarsine
- e) Pavaresia dhe aftesite e Eksperteve Kontrollues duhet te jene te dokumentuara



Ne caktimin e Eksperteve Kontrollues mbahen parasysh kushtet, njohurite profesionale specifike, aftësitë për të përmbushur detyrën si dhe pavarësia në raport me subjektin që do të kontrollohet.

Nuk lejohet kontrolli reciprok, apo ai midis ortakeve të shoqërisë, si dhe midis atyre që kanë qenë ortake para se të kenë kaluar 5 (pese) vite nga koha kur individët kanë qenë në këto pozicione. Nuk lejohet si kontrollues një Kontabilist i Miratuar, i cili vetë ose firma e tij i nënshtrohet kontrollit.

Kur përcaktohet grupi i Kontrolloreve për secilin anëtar, Komiteti i Kontrollit të Cilesisë duhet të sigurojë që nuk ka konflikt interesi midis Eksperteve Kontrollues dhe Kontabilistëve të Miratuar/Shoqërive të Kontabilitetit që janë subjekt i kontrollit, midis Eksperteve Kontrollues dhe Keshillit të Drejtimit.

Cdo Seksion ose Dege me mbi 10 (dhjete) anëtare duhet të ketë të paktën një anëtar të Fondit të Eksperteve Kontrollues.

Një Ekspert Kontrollues nuk mund të shërbejë më shumë se 3 (tre) vite radhazi.

#### **Neni 7**

#### **Miratimi i Kontrolloreve**

Ekspertet Kontrollues miratohen nga Keshilli i Drejtimit, pas propozimit të Komitetit të Kontrollit të Cilesisë. Nuk mund të caktohen si Eksperte Kontrollues anëtare të Keshillit të Drejtimit, anëtare të Komitetit të Kontrollit të Cilesisë si dhe anëtare të Komitetit të Investigimit dhe Disiplinës.

Anëtarët e IKM të caktuar në Fondin e Eksperteve Kontrollues nuk mund të refuzojnë ose të tërhiqen nga kryerja e funksionit, përveç se për arsye të pranuar dhe të argumentuara nga Keshilli i Drejtimit dhe me vendim të tij. Në rast të kundërt do të konsiderohet se kanë kryer shkelje disiplinore dhe ceshtja do të shqyrtohet nga Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës.

#### **Neni 8**

#### **Kontrolli**

Do të bëhet një kontroll i plotë në rastet kur Kontrolli i Cilesisë po realizohet për herë të parë, si dhe në rastet kur kontrollet e mëparshme kanë evidentuar gjetje të rëndësishme. Në cdo rast, cdo



Kontabilist i Miratuar ose Shoqeri Kontabiliteti duhet te jete subjekt i Kontrollit te plote brenda ciklit te percaktuar ne kete Rregullore.

Kontrolli i thelluar do te behet ne ato raste kur Keshilli i Drejtimit ose/dhe Komiteti i Kontrollit te Cilesise e shohet te arsyeshme te kryejte nje kontroll me te thelluar mbi nje ceshtje specifike te sinjalizuara te IKM nepermjet burimeve te jashtme, te ndryshme nga procedurat normale te kontrollit. Keto burime mund te perfshijne:

- a) Sinjalizime qe ka shkelje materiale gjate ofrimit te sherbimit
- b) Informacione nga palet e interesuar dhe agjenci rregullatore
- c) Njoftime publike

Kontrolli duhet te perfshije cilesine e dokumentacionit te angazhimit per ofrimin e sherbimeve, nje vleresim te nivelit te perputhshmerise me Standardet e Aplikueshme te Kontabilitetit, kerkesave te Kodit te Etikes dhe pavarsise, nje vleresim te cilesise dhe sasise te burimeve te shpenzuara si dhe te sistemit te Kontrollit te Brendshem te Cilesise ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Kontrollit te Cilesise dhe Udhezuesit te publikuar nga IKM.

#### **Neni 9**

#### **Fillimi i Kontrollit dhe Procesi i Perzgjedhjes**

Brenda dates 31 Mars te cdo viti, Komiteti i Kontrollit te Cilesise i propozon per miratim Keshillit Drejtues:

- a) Listen e anetareve Kontabiliste te Miratuar (te punesuar ose vetepunesuar) dhe Shoqerive te Kontabilitetit qe do t'i nenshtrohen Kontrollit te Cilesise ne perputhje me Nenin 3 te kesaj rregulloreje, duke perfshire propozimin edhe per listen e mundshme te dosjeve te punes per te perzgjedhur te pakten dy prej tyre per kontroll per secilin anetar
- b) Listen e anetareve Kontabiliste te Miratuar (te vetepunesuar) dhe Shoqerive te Kontabilitetit qe kane angazhime me Njesite me Interes Publik
- c) Listen e Eksperteve Kontrollues
- d) Afatet e kryerjes se kontrollit

Me vendim te Keshillit te Drejtimit, specifikohen faktoret e vlefshem te riskut si dhe vlerat referuese per cdo faktor risku, bazuar ne te dhenat e disponueshme ku perfshihet informacioni i mbledhur nga Kontabilistet e Miratuar dhe Shoqerite e Kontabilitetit.

Ne percaktimin e anetareve qe do te kontrollohen dhe ne perzgjedhjen e dosjeve te punes Komiteti i Kontrollit te Cilesise bazohet ne Deklarimin e Dosjeve te punes per Kontabilistet e Miratuar dhe





## Instituti i Kontabilistëve të Miratuar të Shqipërisë Albanian Institute of Certified Accountants

---

Shoqerite e Kontabilitetit deri me datën 31 Mars të çdo viti. Kjo përzgjedhje do të bazohet në renditjen e mëposhtme:

- a) Ata Kontabilistë të Miratuar (Persona Fizike ose Shoqëri Kontabiliteti) që përgatisin pasqyra financiare dhe ofrojnë shërbime për Njesitë Ekonomike me Interes Publik (NIP) sipas analizës së vlerësimit të riskut. Bazuar në këto renditje, procesi i parviteshem i përzgjedhjes së dosjeve kryhet sipas kësaj radhe:
  - i) Përzgjedhja e Dosjeve mbi baza ciklike
  - ii) Përzgjedhja e Dosjeve të cilat kërkojnë kontrolle të thelluara për shkak të një treguesi risku specifik të lartë, pavarësisht kontrolleve të kryera më parë.
- b) Anëtarët e rinj që janë certifikuar brenda 3 (tre) viteve të fundit
- c) Një herë në çdo 5 (pese) vite për çdo anëtar, dhe pas kontrollit të parë. Prioritet i kushtohet anëtarëve që paraqesin riskun më të madh bazuar në vlerësimin e riskut të bërë sipas katër kritereve:
  - i) Struktura dhe madhësia e Personit Fizik/Shoqërisë së Kontabilitetit
  - ii) Numri i Dosjeve të punës
  - iii) Rezultatet e Kontrollit të Cilësisë të bëra në të kaluarën dhe shkalla e realizimit të veprimeve korrigjuese të kërkuara

Kontrolli për Kontabilistët e Miratuar dhe Shoqëritë e Kontabilitetit do të bazohet në riskun për t'i dhënë prioritet atyre dosjeve që çdo vit paraqesin riskun më të lartë, bazuar në faktorët e riskut.

### **Neni 10** **Afatet**

Kontrolli i Cilësisë duhet të kryhet në afatet e përcaktuara në kalendarin e miratuar nga Këshilli Drejtues dhe në pajtim me programin e Kontrollit të miratuar nga Komiteti i Kontrollit të Cilësisë.

Eksperti Kontrollues duhet të përmbushë detyrën e tij në mënyrë të pavarur. Kontrollori do të kryejë verifikimet që i gjykon të nevojshme dhe do të bëjë rekomandimet që i çmon të dobishme. Në rastin e rikontrolleve, do të ndiqen të njëjtat procedura që zbatohen edhe për kontrollin. Në disa raste kontrollet dhe rikontrollet do të kryhen pranë IKM.

Eksperti Kontrollues ka të drejtën e hyrjes në çdo informacion, që ai e gjykon të nevojshëm për kryerjen e misionit të kontrollit, të perdorë pyetësore sipas Manualit të Kontrollit të Cilësisë, dhe të kërkojë sqarime. Eksperti Kontrollues duhet të verë në dukje, kur është rasti, se nuk ka pasur të drejtë hyrje në të gjithë informacionin e nevojshëm dhe të kërkuar.



Ne perfundim te kontrollit te cilesise grupi i kontrollit hartojne nje Raport i cili i paraqitet Komitetit te Kontrollit te Cilesise per shqyrtim.

Para se te miratohen rezultatet e Kontrollit, Komiteti i Kontrollit te Cilesise, bazuar ne gjetjet e kontrollit, rishikon dosjet e anetareve te kontrolluar dhe shoqerive te kontabilitetit, dhe me pas ja paraqet Keshillit te Drejtimit per miratimin perfundimtar.

Komiteti i Kontrollit te Cilesise therret dhe degjon per mbrojtje te dosjeve, anetaret e kontrolluar dhe Shoqerite e Kontabilitetit ne prani te Eksperteve Kontrollues, sa here qe ai e gjykon te arsyeshme bazuar ne rezultatet e kontrollit.

Brenda nje periudhe 30(tridhjete) ditore pas mbylljes se afatit se kontrollit, cdo te kontrolluari i lind e drejta e ankimimit.

### **Neni 11** **Raportimi**

Raporti i Ekspertit Kontrollues ose Eksperteve Kontrollues duhet te permbaje te pakten informacione per keto ceshtje:

- a) Menyren dhe proceduren si eshte kryer kontrolli
- b) Nje pershkrim dhe vleresim te pergjithshem te struktures dhe aktivitetit te Kontabilistit te Miratuar ose Shoqerise se Kontabilitetit, si dhe cdo informacion tjeter mbi organizimin e brendshem, i cili lidhet me nevojten per te vleresuar ndertimin dhe funksionimin e Kontrollit te Brendshem te Cilesise
- c) Nje pershkrim te menyres se mbajtjes se kontabilitetit dhe realizimit te sherbimeve nga anetari ose shoqeria e kontrolluar
- d) Shkeljet e ligjit, rregullave, standardeve profesionale dhe Kodit te Etikes qe jane konstatuar nga kontrolli
- e) Dobesite dhe neglizhencat e konstatuara
- f) Gjetjet dhe kontrollet e kryera per detyrat dhe rekomandimet e lena nga akt-kontrolli paraardhes
- g) Rekomandimet per anetarin e kontrolluar dhe per Keshillin e Drejtimit, per veprimet qe priten te ndermerren nga ky i fundit ne lidhje me rekomandimet e dhena

Hapat qe do te ndiqen ne dorezimin e raportit jane si meposhte:



- 1) Ne perfundim te kontrollit, zhvillohet nje mbledhje permbyllese ne te cilen diskutohen gjetjet kryesore, duke perfshire anetarin e kontrolluar ose drejtuesit e shoqerise se kontrolluar
- 2) Nje kopje e raportit te kontrollit (nje draft paraprak), Ekspertet Kontrollues ja dorezojne anetarit te kontrolluar apo Shoqerise se Kontabilitetit qe eshte kontrolluar
- 3) Anetari apo Shoqeria e Kontabilitetit qe eshte kontrolluar pergatit komentet per draft Raportin, brenda 2(dy) javeve nga marrja e tij si dhe nje Plan Veprimi per te adresuar mangesite e gjetura
- 4) Ekspertet Kontrollues pergatisin Raportin Final, ku nenshkruajne Ekspertet Kontrollues dhe subjekti i kontrolluar.
- 5) Raporti Final i dergohet Komitetit te Kontrollit te Cilesise, i shoqeruar me dokumentacionin qe pershkruhet ne Udhezimin per zbatimin e Kontrollit te Cilesise, komentet e bera nga i Kontrolluari ne lidhje me gjetjet si dhe nje Plan Veprimi per te adresuar mangesite e gjetura
- 6) Komiteti i Kontrollit te Cilesise pergatit Vleresimin perfundimtar i cili i dergohet Keshillit te Drejtimit per miratim

Ne perfundim te procesit te kontrollit, nje kopje e raportit dergohet te i Kontrolluari dhe nje kopje protokolehet ne arkivat e IKM.

Ne rastet kur ka mosmarreveshje midis te kontrolluarit dhe Eksperteve Kontrollues, Komiteti i Kontrollit te Cilesise organizon nje seance, ku palet thirren te japin shpjegimet e nevojshme ne lidhje me kundershite e tyre. Pasi degjohen palet Komiteti i Kontrollit te Cilesise merr vendimin perkates.

### **Neni 12** **Vleresimi**

Raportet dhe dokumentet e Eksperteve Kontrollues ose te grupeve te Eksperteve Kontrollues shqyrtohen nga Komiteti i Kontrollit te Cilesise. Mbi bazen e ketij vleresimi Komiteti i Kontrollit te Cilesise pergatit vleresimin perfundimtar mbi Kontrollin e Cilesise per dosjen perkatese.

Komiteti i Cilesise ben permbledhjen e kontrolleve te kryera, te perfundimeve dhe rekomandimeve te bera ne Raportin e Kontrollit dhe ia paraqet ato Keshillit te Drejtimit.

Vetem Keshilli i Drejtimit ka te drejte te zyrtarizojte perfundimet e kontrolleve dhe te kerkoje zbatimin e rekomandimeve. Ai per shkelje qe jane subjekt i masave disiplinore, rekomandon



Komitetin e Investigimit dhe Disiplines te marre ne shqyrtim dosjen e te kontrolluarit dhe te marre masat e parashikuara ne Statutin e IKM dhe Rregulloren e Investigimit dhe Disiplines.

Vleresimi i Kontrollit mbeshetet ne tregues lehtesisht te kuptueshem. Vleresimi i Kontrollit do te jete me 4(kater) shkalle si meposhte:

- Dobet – Shoqerohet me veprime disiplinore; problematikat e mangesive kerkojne nje proces disiplinor
- Mjaftueshem – Me mangesi te rendesishme; Ekspertet Kontrollues kane zbuluar disa mangesi te rendesishme dhe do te rekomandoje permiresime thelbesore brenda nje viti.
- Mire – Me mangesi te vogla; Ekspertet Kontrollues do te rekomandojne veprime korrigjuese per t’u kryer.
- Shume mire – Gjetjet nuk jane materiale

Procedurat e ndjekura gjate kontrollit nga Ekspertet Kontrollues mbeshteten ne plotesimin e Manualit te Kontrollit te Cilesise.

Anetaret qe do te rikontrollohen do te perballojne Kostot e Kontrollit

### **Neni 13** **Rikontrolli**

Pas vleresimit perfundimtar nga Keshilli i Drejtimit, ku nje subjekt i kontrolluar ka marre nje vleresim te ndryshem nga “Shume mire”, nje Rikontroll mund te kryhet me kerkese te vete subjektit te kontrolluar, ta pakten 6(gjashte) muaj pas dates se Vleresimit perfundimtar. Gjate procedures se rikontrollit per kete qellim, do te kryehen kontrole dhe per sherbimet si dhe angazhimet qe jane dhene pas periudhes se kontrollit te meparshem.

Nese nje anetar ose Shoqeri Kontabiliteti ne perfundim te procesit te Kontrollit te Cilesise ka marre rekomandime dhe permiresime ne Vleresimin perfundimtar, nje Rikontroll do te kryhet ne vitin pasardhes per te vleresuar statusin dhe zbatimin e Planit te Vleresimit nga ana e te kontrolluarit.

Gjate ketij Rikontrolli do te kete dy vleresime:

- a) Rekomandimet jane permbushur
- b) Rekomandimet nuk jane permbushur

Rikontrolli do te aplikohet se bashku me masa te tjera qe Komiteti i Kontrollit te Cilesise, Keshilli i Drejtimit ose Komiteti i Investigimit dhe Disiplines vendos te marre.

Anetaret qe do te rikontrollohen do te perballojne Kostot e Kontrollit



**Neni 14**

**Konfidencialiteti dhe Pavaresia**

Kontrolli i Cilesise dhe kryerja e sherbimeve te ndryshme kerkojne respektimin rigoroz te Sekretit Profesional si nga ana e Ekspertit Kontrollues ashtu edhe nga anetari i kontrolluar.

Informimi i te treteve, direkt ose indirekt, ne lidhje me faktin se Kontabilisti i Miratuar dhe/ose Shoqeria e Kontabilitetit i eshte nenshtuar detyrimit te kontrollit, dhe/ose gjetjeve dhe rezultateve te Raportit te pergatitur e te perfunduar te Kontrollit te Cilesise, perben shkelje te rregullave te Etikes Profesionale dhe ndershkohet nga procedurat disiplinore.

Ne perputhje me Kodin e Etikes dhe Statutin e IKM, anetaret Komitetit te Kontrollit te Cilesise dhe anetaret e Fondit te Eksperteve Kontrollues duhet te nenshkruajne nje:

- a) Deklarate Konfidencialiteti, per te siguruar ruajtjen e sekretit profesional per informacionet e marra gjate ushtrimit te funksioneve te tyre
- b) Deklarate Pavaresie, per te siguruar se jane te pavaruar dhe nuk kane Konflikt Interesi, cka mund te jete e papajtueshme me objektivitetin e tyre ne ushtrimin e funksioneve te ngarkuara

Te dy deklaratat do te nenshkruhen cdo vit ose nese do te kete ndryshime te cilat kerkojne nje deklarate te re, brenda 15(pesembedhjete) diteve nga ndryshimi, nese ka.

Pavarsisht sa mesiper, Ekspertet Kontrollues perpara nise se procedurave te Kontrollit te Cilesise per anetaret qe u caktohen, do te nenshkruajne per cdo rast nje Deklarate Pavaresie te vecante.

Raportet Kontrollit dhe cdo dokument tjetër qe lidhet me kontrollet jane dokumenta te brendshme te Institutit te Kontabilistëve te Miratuar dhe permbajtja e tyre nuk mund te perhapet te tretet. Rezultatet e pergjithshme te Sistemit te Kontrollit te Cilesise publikohen cdo vit nga IKM, ne menyre te permbledhur dhe pa permendur emra te vecante.

Rekomandimet e Komitetit te Kontrollit te Cilesise duhet te ndiqen nga anetaret per t'u zbatuar brenda nje periudhe kohore te vendosur nga ky Komitet ose Keshilli i Drejtimit.



## Instituti i Kontabilistëve të Miratuar të Shqipërisë Albanian Institute of Certified Accountants

### Neni 15 Ankimimi

Pas mbylljes së procesit të Kontrollit të Cilesisë, brenda një periudhe 30(tridhjetë) ditore, anëtarët ose Shoqërisë së Kontabilitetit të kontrolluar, i linden drejtat e ankimeve Raportin e Kontrollit pranë Komitetit të Kontrollit të Cilesisë.

Komiteti i Kontrollit të Cilesisë me kërkesë të ankimuesit, brenda 30(tridhjetë) ditëve nga marrja e ankimimit, organizon një mbledhje ku janë të pranishëm Anëtarët e Komitetit, subjekti i kontrolluar, Ekspertët Kontrollues. Pasi merren shpjegimet e nevojshme nga palët, Komiteti i Kontrollit të Cilesisë, paraqet brenda 30 ditëve, në përputhje me Rregulloren përkatëse dhe pasi ka kryer verifikimet e nevojshme, vendimin ndaj ankesës së bërë së bashku me propozime konkrete.

Njoftimi për mbledhjen e Komitetit të Kontrollit të Cilesisë për palët bëhet të pakten 10(dhjetë) ditë para datës së mbledhjes. Në rast mosparaqitje, shqyrtimi bëhet në bazë të dokumentacionit të dorëzuar.

**Miratuar nga Asambleja e përgjithshme e IKM**

**28 Shtator 2019**

**Kryetari i Keshillit të Drejtimit**



**Prof. Dr. Sotirag DHAMO**